



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 159

Tiranë – E mërkurë, 24 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 585, datë 13.7.2016	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 28,018 ha, në ekonominë pyjore “Rrotull”, të ndodhur në Gjirin e Lalëzit, bashkia Durrës, qarku Durrës, që do të përdoret për ndërtimin e një kompleksi turistik rezidencial, hotelier.....	19965
Kërkesë e Ministrisë së Kulturës nr. 4292, datë 19.8.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërrhyrje rehabilituese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike të Dhërmiut”.....	19965

**VENDIM**

Nr. 585, datë 13.7.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË
SIPËRFAQES PREJ 28,018 HA, NË
EKONOMINË PYJORE “RROTULL”, TË
NDODHUR NË GJIRIN E LALËZIT,
BASHKIA DURRËS, QARKU DURRËS, QË
DO TË PËRDORET PËR NDËRTIMIN E
NJË KOMPLEKSI TURISTIK
REZIDENCIAL, HOTELIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 28,018 (njëzet e tetë presje tetëmbëdhjetë) ha, në ngastrat 70abcd të ekonomisë pyjore “Rrotull”, që do të përdoret nga shoqëria “Omnix Albania”, sh.p.k. për ndërtimin e një kompleksi turistik rezidencial, hotelier, të hiqet nga fondi pyjor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja, sipas ngastrave pyjore, jepet në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Sipërfaqet pyjore që hiqen nga fondi pyjor dhe që janë pronë publike e shtetit, sipas kartelave të pasurisë së paluajtshme, bashkëlidhur këtij vendimi, të regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Omnix Albania”, sh.p.k.

3. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Publike të bëjë çregjistrimin e sipërfaqeve pyjore, të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore/kullosore” dhe ta regjistrojë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ndërtimin e një kompleksi turistik rezidencial, hotelier”.

4. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes së hequr dhe të infrastrukturës së saj të paguhen nga subjekti “Omnix Albania”, sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

5. Ministria e Mjedisit dhe Shoqëria “Omnix Albania”, sh.p.k., të hartojnë marrëveshje të përbashkët, lidhur me pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër.

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËRVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

Tabela nr. 1

**Koordinatat e ngastrës pyjore, e cila hiqet
nga fondi pyjor**

KOORDINATA		
Pika	Y	X
1	376076	4599732
2	375960	4600651
3	376127	4600700
4	376167	4600566
4/1	376235	4600599
5	376343	4600509
5/1	376324	4600502
6	376396	4599849
6/1	376485	4599874
6/2	376422	4599854
7	376457	4600600
8	376511	4600556

KËRKESË

Nr. 4292, datë 19.8.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje rehabilituese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike të Dhërmiut”

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2015”.



Pronarët që kanë emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Pronarët e konfirmuar nga ZVRPP Vlorë, do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së

vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është gjithsej 7,464,400 (shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË KULTURËS
Elira Kokona

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m ²)		Çmimi lekë/m ²		Vlera lekë		SHENIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Njesi	
1	Areti Zaho	1481	28		40.00		32,516	-	1,300,640.00	sipas vërtetimit të pronësisë
2	Thodhori Duni	1481	1	270.000	160.00	3,560	32,516	961,200	5,202,560.00	sipas regjistrit hipotekor
				270.00	200.0	3,560	32,516	961,200	6,503,200	7,464,400
				Totali:	7,464,400					

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë